



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Rezultatet kyçe nga Anketa Bazë mbi Inspektimet

Përgatitur nga: Projekti i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (CERP)

Data: Dhjetor 2023

1. Objektivat

Projekti i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (CERP) i financuar nga Banka Botërore, i implementuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka për synim që t'u mundësojë firmave vendore të eksportojnë më shumë dhe të rishpërndajnë burimet të cilat ato i dedikojnë/ndajnë për t'u marrë me inspektimet e vështira dhe për pengesat e tjera të mjedisit të biznesit për një shfrytëzim më produktiv të tyre. Projekti CERP në bashkëpunim të ngushtë me projektin Kosova Investment Climate II, i zbatuar nga IFC dhe i financuar nga SECO (Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike) dëshiron të paraqesë rezultatet kryesore nga anketa bazë e kryer nga ana e Projektit të IFC-së, Klima e Investimeve në Kosovë, për të vlerësuar aspekte të ndryshme lidhur me inspektimet e kryera në vitet 2021 dhe 2022. Ndërsa në vitin 2023 anketa është kryer nga Projekti CERP. Anketa kishte për qëllim të masë treguesit e rezultateve të Projektit të IFC-së në lidhje me mbulueshmërinë e inspektimeve, inspektoratet e përfshira, kohëzgjatjen e inspektimeve, kostot administrative, gjobat e paguara, ndërgjegjësimin dhe perceptimin e bizneseve si dhe faktorë të tjerë përkatës.


Projekti për Klimën e Investimeve ofron asistencë teknike për Qeverinë e Kosovës me qëllim të përmirësimit të klimës së investimeve në vend si për investitorët vendor ashtu edhe për ata të huaj. Komponenti i rregullimit të biznesit të projektit mbështet qeveritë në nivel kombëtar dhe komunal për të reduktuar barrën administrative për bizneset përmes sistemit të thjeshtuar të dhënies së licencave dhe lejeve, si dhe nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve të inspektimit.

2. Treguesit

1. Mbulueshmëria e Inspektimeve (pjesa e bizneseve të inspektuara):

Në vitin 2022, mbulueshmëria e inspektimeve përfshinte 67% të bizneseve. Kjo tregon se afërsisht dy të tretat e bizneseve të anketuara i janë nënshtruar inspektimeve gjatë periudhës së specifikuar kohore.

Në vitin 2021, rezultatet e anketës zbuluan se 55.4% e bizneseve janë inspektuar, duke treguar se pak më shumë se gjysma e bizneseve i janë nënshtruar proceseve të inspektimit. Megjithatë, në vitin 2022, mbulueshmëria e inspektimeve u rrit në 67%, duke treguar një përmirësim të dukshëm në shtrirjen e inspektimit. Ndërsa gjatë vitit 2023, mbulueshmëria u rrit në 84,67%.



Grafiku 1 Mbulueshmëria e inspektimeve

2. Inspektoratet e përfshira në inspektime

Anketa zbuloi se inspektimet kryesisht janë kryer nga tre inspektorate: Inspektorati i Punës, Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe Inspektorati i Tregut. Shpërndarja e inspektimeve ndërmjet këtyre inspektorateve ishte si vijon:


- Në vitin 2021:
 - Inspektorati i Punës (56.5%)
 - Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinës (14.8%)
 - Inspektorati i Tregut (14.4%)

- Në vitin 2022:
 - Inspektorati i Punës (53.6%)
 - Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinës (15.4%)
 - Inspektorati i Tregut (14.6%)

- Në vitin 2023:
 - Inspektorati i Punës (49%)
 - Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinës (21%)
 - Inspektorati i Tregut (23%)

Në krahasim me vitin paraprak, ka një ndryshim të vogël në përqindjen e inspektimeve nga Inspektorati i Punës, ndërsa ka një rritje në përqindjen e inspektimeve nga Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinës dhe Inspektorati i Tregut në vitin 2023.

Përqindja e mbetur përfaqëson inspektoratet e tjera të specifikuara si më poshtë:




Grafiku 2 nga cilat inspektorate janë inspektuar më së shumti bizneset

3. Kohëzgjatja mesatare e inspektimeve për ndërmarrje/vit (për orë)

Ky indikator tregon kohën mesatare ose gjatësinë e inspektimit për çdo biznes në vit, duke përfshirë kohën e përgatitjes, inspektimit dhe kohën e pas inspektimit. Në vijim janë kohërat mesatare për secilin vit:

- Në vitin 2021: 13.83 orë
- Në vitin 2022: 8.82 orë
- Në vitin 2023: 1.44 orë

Rezultatet tregojnë një zvogëlim të konsiderueshëm të kohës mesatare të inspektimit për secilin biznes nga viti 2021 në vitin 2023.



Grafiku 3 Kohëzgjatja mesatare ose kohëzgjatja e inspektimit për ndërmarrje/vit

4. Kostoja mesatare administrative direkte lidhur me administrimin e vizitave inspektuese për biznes/për vizitë/në vit (të ndara në bazë të secilit inspektorat)

Kosto mesatare administrative drejtpërdrejt lidhur me administratën e vizitave të inspektimit: kopjimi i dokumenteve, testimi, dërgimi i dokumenteve dhe kostot e transportit nëse aplikohet (për të shkuar në inspektoratin etj.), duke përfshirë kostot e jashtme për çdo biznes/çdo vizitë/çdo vit.

- Në 2021: 37.7 EUR
- Në 2022: 26.14 EUR
- Në 2023: 11.92 EUR

Analiza e këtyre rezultateve tregon një trend zvogëlimi të kostove administrative të drejtpërdrejta të lidhura me inspektimet gjatë kohës. Në vitin 2021, kostoja mesatare ishte 37.7 EUR për çdo

vizitë inspektimi, ndërsa kjo shifër u zvogëlua në 26.14 EUR në vitin 2022 dhe më tej në 11.92 EUR në vitin 2023.




Grafiku 4 Kostoja mesatare administrative direkte lidhur me administrimin e vizitave inspektuese

5. Shuma mesatare e gjobave të paguara për biznes në vit

Shuma mesatare e gjobave të paguara për çdo biznes/çdo vit:

- Në 2021: 34.20 EUR
- Në 2022: 105.66 EUR
- Në 2023: 85.11 EUR

Analiza e këtyre rezultateve tregon një rritje të shumës mesatare të gjobave të paguara nga bizneset gjatë kohës. Në vitin 2021, shuma mesatare ishte 34.20 EUR për çdo biznes në vit, ndërsa kjo shifër u rrit në 105.66 EUR në vitin 2022 dhe pastaj u zvogëlua në 85.11 EUR në vitin 2023.




Grafiku 5 Shuma mesatare e gjobave të paguara për biznes/në vit

6. Përqindja e gjobave të paguara për shkak të mospajtueshmërisë

Pjesa e gjobave të paguara për shkak të mungesës së pajtueshmërisë?

- Në 2021: 49%
- Në 2022: 67%
- Në 2023: 57%

Analiza e këtij indikator tregon një rritje të pjesës së gjobave të paguara për shkak të mungesës së pajtueshmërisë nga vit në vit. Në vitin 2021, 49% e gjobave ishin të lidhura me mungesën e pajtueshmërisë me rregulloret dhe rregullat, ndërsa kjo përqindje u rrit në 67% në vitin 2022 dhe më pas u zvogëlua në 57% në vitin 2023.



Grafiku 6 Përqindja e gjobave të paguara për shkak të mospajtueshmërisë

7. Përqindja e gjobave të paguara për shkak të kërkesave të paqarta ose jokonsistente ndaj inspektorëve

Pjesa e gjobave të paguara për shkak të kërkesave të paqarta ose të pasigurta ndaj inspektorëve?

- Në 2021: 21%
- Në 2022: 17%
- Në 2023: 24%

Analiza e këtij indikator tregon një ndryshim të pjesës së gjobave të paguara për shkak të kërkesave të paqarta ose të pasigurta ndaj inspektorëve gjatë kohës. Në vitin 2021, 21% e gjobave ishin të lidhura me pasigurinë ose paqartësinë e kërkesave të inspektorëve, ndërsa kjo përqindje u zvogëlua në 17% në vitin 2022 dhe më pas u rrit në 24% në vitin 2023.




Grafiku 7 Përqindja e gjobave të paguara për shkak të kërkesave të paqarta ose jokonsistente ndaj inspektorëve

8. "Përqindja e bizneseve që janë njoftuar paraprakisht për qëllimin e inspektimit dhe të vizitës"

Analiza e rezultateve të anketës për inspektimet tregon një trend zbritës në nivelin e informimit paraprak të bizneseve. Nga vit në vit, ka një rënie në përqindjen e rasteve ku bizneset informohen për qëllimin e inspektimit dhe synimet e vizitës para se të ndodhë inspektimi. Në vitin 2021, vetëm


42% e rasteve treguan informim paraprak, ndërsa ky numër zvogëlohet në 27% në 2022 dhe 21.28% në 2023.



Grafiku 8 Përqindja e bizneseve që janë njoftuar për qëllimin e vizitave inspektuese

9. Kënaqësia e bizneseve me performancën dhe sjelljen e inspektorit gjatë vizitës inspektuese

Rezultatet e anketës bazë tregojnë një trend të qëndrueshëm rritës në nivelin e kënaqësisë së bizneseve me performancën e inspektorëve gjatë inspektimit. Nga 87% e kënaqësisë në vitin 2021, ka pasur një rritje në 94.44% në vitin 2023. Kjo shënon një përmirësim të vazhdueshëm dhe një përcaktim pozitiv nga ana e bizneseve ndaj sjelljes dhe performancës së inspektorëve.



Grafiku 9 Kënaqësia e bizneseve me performancën e inspektorit

10. Perceptimi i bizneseve që mendojnë se inspektorët janë të vetëdijshëm për aspektet teknike dhe shkencore të nevojshme për inspektim


Rezultatet e anketës për perceptimin e bizneseve mbi dijeninë e inspektorëve në aspektet teknike dhe shkencore të nevojshme për inspektim janë pozitive dhe tregojnë një besim të vazhdueshëm të bizneseve në aftësitë e inspektorëve:

- Në vitin 2021: 90% e bizneseve thanë po.
- Në vitin 2022: 95.7% e bizneseve thanë po.
- Në vitin 2023: 94.93% e bizneseve thanë po.

11. Niveli i ndërgjegjësimit të bizneseve për procedurat e inspektimit dhe detyrimet ligjore dhe teknike

Rezultatet e anketës për nivelin e vetëdijes së bizneseve lidhur me procedurat e inspektimit dhe detyrimet ligjore dhe teknike janë shumë pozitive dhe tregojnë një rritje të qëndrueshme në vetëdijen e tyre:

- Në vitin 2021: 94.4% e bizneseve thanë po.
- Në vitin 2022: 95.5% e bizneseve thanë po.
- Në vitin 2023: 97% e bizneseve thanë po.



Grafiku 10 Niveli i ndërgjegjësimit të bizneseve për procedurat e inspektimit dhe detyrimet ligjore dhe teknike

12. Perceptimi i bizneseve për problemet kryesore në inspektim

Rezultatet e anketës mbi perceptimin e bizneseve lidhur me problemet kryesore në inspektim tregojnë ndryshime në identifikimin e sfidave kryesore nga viti në vit:

- Viti 2021:
 - *Kërkesa të paqarta teknike dhe ligjore: 22%*
 - *Kostot e larta të kërkesave të inspektimit: 15.6%*
 - *Shpeshtësia e madhe e vizitave: 13%*
 - *Dyfishimi dhe mbivendosjet e inspektimeve: 11%*
- Viti 2022:
 - *Kërkesa të paqarta teknike dhe ligjore: 5.5%*
 - *Kostot e larta të kërkesave të inspektimit: 5.6%*

- *Shpeshtësia e madhe e vizitave: 1.7%*
- *Dyfishimi dhe mbivendosjet e inspektimeve: 1.4%*


- **Viti 2023:**
 - *Kërkesa të paqarta teknike dhe ligjore: 33%*
 - *Kostot e larta të kërkesave të inspektimit: 16%*
 - *Shpeshtësia e madhe e vizitave: 11%*
 - *Dyfishimi dhe mbivendosjet e inspektimeve: 8%*

Tendencat dhe përfundimet:

Problematika e "Kërkesa të paqarta teknike dhe ligjore" ka pësuar një rritje të dukshme nga viti 2022 në vitin 2023.

Kostot e larta dhe shpeshtësia e madhe e vizitave kanë mbetur problematikat kryesore në të gjitha vitet, megjithatë ka një lehtësim i lehtë në vitin 2022 dhe një rritje sërish në vitin 2023.

Dyfishimi dhe mbivendosjet e inspektimeve kanë pësuar një lehtësim të ndjeshëm nga viti 2021 në vitin 2022, por ka një rritje sërish në vitin 2023.



Grafiku 11 Perceptimi i bizneseve për problemet kryesore në inspektim

13. Niveli/përqindja e ndryshimit të procesit të inspektimit gjatë viteve të fundit

Të anketuarve iu kërkua të tregonin nëse ata kanë perceptuar ndonjë ndryshim në procesin e inspektimit dhe, nëse po, të specifikonin nëse ndryshimet ishin pozitive, negative, apo nëse nuk kishte ndryshime. Rezultatet e anketës së niveleve të ndryshimit në procesin e inspektimit në vitet 2021, 2022 dhe 2023 janë si vijon:

Stabiliteti i Procesit:


Nuk ka ndryshime: Përqindja e lartë (68%) tregon për një stabilitet të qëndrueshëm në procesin e inspektimit gjatë të tre viteve.

Ndryshime Pozitive:

Tendencë Rritëse: Nga 26% në 2021, në 30% në 2022, dhe më në fund në 37% në 2023. Kjo tregon për një përmirësim të konsiderueshëm gjatë këtyre viteve.

Ndryshime Negative:

Ulje e Përgjithshme: Përqindja e ndryshimeve negative është zvogëluar nga 6% në 2021, në 2% në 2022, dhe ka mbetur 2% në 2023. Ky është një indikator i favorshëm për stabilitet.



Grafiku 12 Niveli/përqindja e ndryshimit (pozitiv, negativ dhe neutral) i procesit të inspektimit gjatë viteve të fundit

3. Konkluzionet

Krahasim midis të dhënave nga 2021, 2022 dhe 2023 është dhënë për të nxjerrë në pah tendencat dhe variacionet. Janë vërejtur gjetjet e mëposhtme:

Mbulueshmëria e inspektimeve u rrit nga 55.4% në vitin 2021 në 67% në vitin 2022 dhe 84% në vitin 2023, duke treguar një shtrirje më të gjerë të inspektimeve dhe një përqindje më të lartë të bizneseve që inspektohen.

Inspektori i Punës ka qenë inspektori kryesor në të tre vitet, por përqindja e inspektimeve nga Inspektori i Ushqimit dhe Veterinës dhe Inspektori i Tregut është rritur gradualisht në vitin 2023.

Kohëzgjatja mesatare e inspektimeve u ul nga 13,83 orë në vitin 2021 në 8,82 orë në vitin 2022, dhe në vitin 2023 kohëzgjatja e inspektimeve u ul në 1.44 ore që tregon procedura më të thjeshta dhe më efikase për kohën e inspektimit.

Kostoja mesatare administrative direkte për biznes për vizitë në vit u ul nga 37.7 Euro në vitin 2021 në 26.14 Euro në vitin 2022, dhe në vitin 2023 kjo kosto ra në 11.92 Euro duke sugjeruar masa të kursimit të kostos dhe rritjen e efikasitetit administrativ.

Shuma mesatare e gjobave të paguara për biznes në vit ka pësuar një rritje nga 34.20 EUR në 2021 në 85.11 EUR në 2023.

Pjesa e gjobave të paguara për shkak të mungesës së pajtueshmërisë ka pësuar rënie nga 67% në 2022 në 57% në 2023..

Përqindja e bizneseve të informuara paraprakisht ka rënë nga 42% në 2021, në 27% në 2022, dhe në 21.28% në 2023.

Kënaqshmëria e bizneseve me performancën dhe sjelljen e inspektorëve gjatë inspektimeve ka shënuar një rritje të vazhdueshme nga 87% në 2021, në 94.4% në 2022, dhe në 94.44% në 2023..

Përqindja e bizneseve që besojnë se inspektorët janë të informuar për aspektet teknike dhe shkencore të nevojshme për inspektim ka qëndruar në nivele të larta në të gjithë vitet..

Niveli i vetëdijes së bizneseve për procedurat e inspektimit dhe detyrimet ligjore dhe teknike ka rritur nga viti në vit.

Bizneset kanë identifikuar ndryshime në problemet kryesore me kalimin e kohës, duke përfshirë ndryshime në kërkesat teknike dhe ligjore, koston e lartë, dhe frekuencën e vizitave.

Rezultatet nga anketa për Nivelin/përqindjen e ndryshimit në procesin e inspektimit tregon se ka një përmirësim në perceptimin e ndryshimeve në procesin e inspektimit nga ana e subjekteve të anketës. Rritja e ndjeshme e ndryshimeve pozitive në vitin 2023 sugjeron një përparim të vazhdueshëm në përgjithësi, ndërsa ndryshimet negative mbeten në nivele të ulëta.

Rezultatet e anketave për procesin e inspektimit tregojnë një përmirësim të vazhdueshëm në mbulueshmërinë e inspektimeve dhe efikasitetin e tyre, duke shfaqur një rritje të qëndrueshme në përqindjen e bizneseve të inspektuara. Gjithashtu, ka një trend zvogëlues në koston e inspektimit dhe kohën e përgjithshme të kryerjes së inspeksioneve. Një fakt pozitiv është rritja e kënaqësisë së bizneseve me performancën e inspektorëve, ndërsa vazhdimi i përmirësimeve është i rëndësishëm për të siguruar një mjedis të favorshëm për bizneset.